



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA KORÇË
KRYETARI

Nr. 1198 prot.

Korçë më 19 . 12 .2019

URDHËR
NR. 117 DATË 19 . 12 .2019

**PËR MIRATIMIN E RREGULLORES “PËR HETIMIN ADMINISTRATIV TË
SINJALIZIMIT DHE MBROJTJEN E KONFIDENCIALITETIT NË BASHKINË
KORÇË”**

Bazuar në nenin 64 “Kompetencat dhe detyrat e Kryetarit” të ligjit 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, ligjin nr. 60/2016, “Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve”, Kodin e Procedurave Administrative, VKM-në nr. 816, datë 16.11.2016 “Për strukturën, kriteret e përzgjedhjes dhe marrëdhëniet e punës së punonjësve të njësisë përgjegjëse në autoritetet publike, në zbatim të ligjit nr.60/2016, “Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve”, si dhe udhëzimeve dhe akteve të tjera nënligjore të miratuara nga Inspektori i Përgjithshëm i ILDKPKI,

URDHËROJ:

1. Miratimin e Rregullores “Për hetimin administrativ të sinjalizimit dhe mbrojtjen e konfidencialitetit në bashkinë Korçë”, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij urdhëri.
2. Për zbatimin e këtij urdhëri ngarkohen të gjitha Drejtoritë, Rajonet dhe Njësitë Administrative pranë Bashkisë Korçë dhe Ndërmarrjet në varësi si më poshtë:
 - Ndërmarrja e Shërbimeve Publike;
 - Ndërmarrja e Shërbimeve të Arsimit dhe Çerdhes;
 - Qendra e Artit dhe Kulturës;
 - Njësia e Menaxhimit të Banesave Me Qëllim Social;
 - Klubi Shumësportësh “Skënderbeu”.
3. Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I BASHKISË
Sotiraq Filo

